



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:223938

Datë: 13.07.2023

Numri i dokumentit: 04486409

C.nr.2148/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Njomëza Berisha, në çështjen juridike-kontestimore të paditëses M.M., nga Prizreni, rruga ".....", nr....., të cilën me autorizim e përfaqëson M.G., nga Prizreni, kundër të paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, e me autorizim avokati shtetëror B.K., i autorizuar nga avokatja e përgjithshme shtetërore F.G., për shkak të kontestit të punës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datë 13.06.2023, morri këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar** kërkesëpadia e paditëses M.M., nga Prizreni me të cilën ka kërkuar që të: *"I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.M., nga Prizreni. II.DETYROHET e paditura Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit-Qendra Burimore Nëna Tereza në Prizren, që paditëses M.M., t'ia bëjë ndërrimin e kontratës së punës nga edukatore në mësimdhënëse e gjuhës shqipe. III DETYROHET e paditura që të bëjë kompensimin e diferencës së pagës ndërmjet pozitës së punës së mësimdhënëses së gjuhës shqipe dhe të edukatores: në emër të pagave neto shumën prej 583.91 euro, në emër të kontributit pensional të të punësuarit shumën prej 31.85 euro, në emër të kontributit pension të punëdhënësit shumën prej 31.85 euro, në emër të tatimit në të ardhura personale shumën prej 21.24 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. IV.DETYROHET e paditura që të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 78 euro, për ekspertizë financiare shumën prej 100 euro, për dy seanca të mbajtura shumën prej 202.80 euro, për dy seanca të shtyra pa fajin e përfaqësuesit të autorizuar 101.40 euro, të përcaktuara nga Tarifa e Odës së Avokatëve, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm."*
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja M.M., nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 06.10.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurit Y.Sh., nga Prizreni, për shkak të kthimit të orëve të gjuhës shqipe. Përmes parashtrësës së saj të datës 04.02.2022, e ka precizuar në aspektin subjektiv ashtuqë në vend të paditurit Y.Sh., si të paditur në këtë procedurë e ka përcaktuar Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me seli në Prishtinë.

Në padi ka theksuar se Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me datë 21.07.2021, me vendimin me numër 1676/2 ka aprovuar ankesën e M.M.,t me numër të protokollit 1676 të datës 27.08.2021 dhe ka anuluar procedurën e rekrutimit në AMU e shpallur në gazetën ditore “Epoka e Re”, 01.07.2021, me të cilën OBLIGOHET komisioni vlerësues që nga fillimi të rishikoj dhe rivlerësoj dokumentacionin e kandidatëve aplikues dhe të zhvilloj procedurat e rekrutimit për kandidatët që i plotësojnë kushtet e parapara me konkursin e datës 01.07.2021 konform legjislacionit në fuqi. Duke qenë se nuk është vepruar në bazë të këtij vendimi paditësja ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar që në pozitën e kandidatës përzgjedhëse me kualifikim për pozitën mësimdhënëse e gjuhës shqipe në AMU pranë Qendrës Burimore Nëna Tereza në Prizren, në konkursin e datës 14.07.2021, të jetë paditësja M.M.,, pasiqë e njejtja i plotëson të gjitha kriteret duke e obliguar që ta rikthej në orët e mësimi të gjuhës shqipe me kontratë të rregulltë të punës dhe të detyrohet e paditura që ta respektoj këtë vendim. Si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Me parashtrësën e datës 29.09.2022, e ka precizuar padinë në aspektin objektiv duke kërkuar nga gjykata që të e aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses e përmes së cilës të bëjë kthimin e orëve dhe ndërrimin e kontratës së punës nga kontrata e edukatores në kontratë të punës si mësimdhënëse e gjuhës shqipe, duke ia kompensuar orët e mbajtura për 5 vite, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare e autorizuara e paditëses ka deklaruar se mbetet në tërësi si në padi dhe në precizimin e bërë padisë duke kërkuar nga gjykata që padia e paditëses të aprovohet si e bazuar. Ka shtuar se në bazë të nenit 38 par.1 të Ligjit për Zyrtarët publik “ Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nënparagrafit 4.1 të nenit 37 të këtij ligji....”, dhe se pikërisht kjo dispozitë ligjore dhe provat të cilat dëshmojnë se e njëjta ka mbajtur orët e gjuhës shqipe, i japin të drejtën e ndërrimit të kontratës nga kontrata e edukatores në kontratën e mësimdhënëses së gjuhës shqipe. Si provë gjykatës i është dorëzuar vërtetimi i lëshuar nga drejtori i qendrës burimore në Prizren, të datës 09.12.2022 e cila vërteton më së miri se paditësja i ka mbajtur orët e gjuhës shqipe pranë kësaj qendre dhe vazhdon ti mbaj ende, andaj nuk mbetet zgjidhje tjetër përpos rrugës gjyqësore që ti njihet e drejta e ndërrimit të kontratës së punës. Paditësja në vazhdimësi ka bërë kërkesë për ndërrimin e kontratës së saj nga edukatore në mësimdhënëse e gjuhës shqipe por e paditura nuk ka dhënë asnjë përgjigje në këto kërkesa edhe e ka neglizhuar në çdo formë, duke hapur konkurse të reja edhe pse e dinte se paditësja i plotëson kriteret për punësim dhe e njihte gjuhën e personave me aftësi të kufizuar-memecëve.Sa i përket kompensimit të orëve të mbajtura, gjatë procedurës eksperti financiar ka bërë ekspertizën financiare ndaj së cilës nuk kanë pasur vërejtje. Andaj ka kërkuar nga gjykata që aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.M., nga Prizreni dhe të detyrohet e paditura Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit-Qendra Burimore Nëna Tereza në Prizren, që paditësja M.M., tia bëjë ndërrimin e kontratës së punës nga edukatore në mësimdhënëse e gjuhës shqipe. Gjithashtu ka kërkuar që të detyrohet e paditura që të bëjë kompensimin e diferencës së pagës ndërmjet pozitës së punës së mësimdhënëses së gjuhës shqipe dhe të edukatores: në emër të pagave neto shumën prej 583.91 euro, në emër të kontributit pensional të të punësuarit shumën prej 31.85 euro, në emër të kontributit pension të punëdhënësit shumën prej 31.85 euro, në emër të tatimit në të ardhura personale shumën prej 21.24 euro, në afat prej

7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. Si dhe të detyrohet e paditura që të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 78 euro, për ekspertizë financiare shumë prej 100 euro, për dy seanca të mbajtura shumë prej 202.80 euro, për dy seanca të shtyra pa fajin e përfaqësuesit të autorizuar 101.40 euro, të përcaktuara nga Tarifa e Odës së Avokatëve, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Në përgjigje në padi, seanca të mbajtura dhe në fjalën e fundit të dorëzuar me shkrim e paditura ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, duke theksuar se bazuar në udhëzimin Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, neni 4 pika 6 përcaktohet se: “organi përkatës me statut dhe aktin e brendshëm duhet të shpall konkurs të brendshëm nëse ka më shumë kandidat të cilët i plotësojnë kushtet e kërkuara për plotësimin e vendeve të lira të punës “. E paditura në këtë rast ka respektuar këtë procedurë ligjore dhe ngase nuk ka pasur kushte ligjore për shpalljen e konkursit të brendshëm, ka shpallur konkurs të jashtëm. Për këto arsye e paditura ka shpallur konkurs, në të cilin ka konkuruar edhe paditësja por që nuk e ka kaluar pragun për testim dhe vlerësim me gojë. Në anën tjetër komisioni vlerësues është obliguar që të rishikoj dhe vlerësoj dokumentacionin e kandidatëve, gjë që komisioni e ka bërë, konform ligjit dhe rekomandimeve të Sekretarit të Përgjithshëm të MASHTIT dhe bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.07/2017, me datë 21.12.2021 ka shpallur konkurs, për të njëjtin vend të punës, ku paditësja nuk ka treguar rezultate në testin me shkrim dhe e ka humbur të drejtën për pjesën tjetër të testimit me gojë. Në këtë drejtim kanë propozuar refuzimin e padisë si të pathemeltë.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen, në procedurën e provave, në shqyrtim kryesor publik, sipas propozimit të palëve ka administruar provat si në vijim: leximin e ekspertizës financiare të datës 07.04.2023 të ekspertes Arjeta Kololli si dhe ka bërë dëgjimin e saj në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 08.05.2023, leximin e vendimit të Ministrisë së Arsimit me numër 1676/2-K të datës 21.09.2021, leximi i kërkesave të datave 29.06.2021, 29.06.2019, 07.04.2022, 24.06.2019, 29.06.2021, 28.04.2021, 11.12.2018, 29.12.2017, 03.10.2018, 13.10.2014, leximi i nënshkrimeve të stafit të Qendrës Burimore, leximi i kontratës së punës me numër të protokollit 3/1048-35 datë 02.03.2016, leximi i aktvendimit mbi licencimin e mësimdhënësit me numër 08/2013/11511, leximi i vërtetimit të datës 12.04.2022, leximi i vërtetimit 14.12.2022, leximi i listës së ndarjeve të orëve mësimore 09.06.2021, leximi i ankesës së datës 21.09.2021, leximi i listës së individualizuar për orët e gjuhës shqipe, leximi i orarit mësimor 2018-2019 dhe 2019-2020, leximi i faqeve të ditarit të vitit 2018, leximi i planprogramit të orëve 2022, leximi i ankesës së datës 01.06.2022, leximi i përgjigjes në ankesë 02.03.2022, leximi i shpalljes së konkursit të datës 21.12.2021, leximi i vendimit mbi emërimin e komisionit të datës 12.01.2022, leximi i njoftimit mbi përzgjedhjen e kandidatëve, leximi i testit me shkrim, leximi i njoftimit për kandidatin e përzgjedhur për pozitën mësimdhënës i gjuhës shqipe.

Gjykata pas vlerësimit të provave në përputhje me dispozitat e nenit 8 të LPK-së, gjeti se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsyet që jepen në vijim.

Nga leximi i ekspertizës financiare të datës 07.04.2023 të ekspertes Arjeta Kololli si dhe me dëgjimin e ekspertës në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 08.05.2023, gjykata ka vërtetuar se në bazë të llogaritjeve të paraqitura nga ekspertja diferenca në mes të pagës së edukatores dhe mësimdhënës për periudhën 2018/2019 dhe 2019/2020 është si në vijim: paga neto në shumë prej 583.91 euro, kontributi pensional në ngarkesë të punëdhënësit në shumë prej 31.85 euro,

kontributi pensional nël ngarkesë të punëtorit në shumën prej 31.85 euro si dhe tatimi në burim në shumën prej 21.21 euro. Ndërsa në periudhën 2020/2021 dhe 2021/2022 paga ka qenë e njëjtë si për edukatorët ashtu edhe për mësimdhënësit.

Nga vendimi i Ministrisë së Arsimit me numër 1676/2-K të datës 21.09.2021, gjykata ka vëretuar se përmes këtij vendimi është aprovuar ankesa e M.M.,t me numër të protokollit 1676 e datës 27.08.2021 dhe është anuluar procedura e rekrutimit e për pozitën mësimdhënëse në AMU në konkursin e shpallur me datë 01.07.2021 në gazetën “Epoka e Re”, dhe është obliguar komisioni vlerësues që të rishqyrtoj dhe rivlerësoj dokumentacionin e kandidatëve aplikues.

Nga leximi i kërkesave të datave 29.06.2021, 29.06.2019, 07.04.2022, 24.06.2019, 29.06.2021, 28.04.2021, 11.12.2018, 29.12.2017, 03.10.2018, 13.10.2014, gjykata ka vërtetuar se këtu paditësja ka bërë kërkesa të vazhdueshme në Ministri të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për ndërrim të kontratës së punës nga edukatore në mësimdhënëse e gjuhës shqipe.

Nga leximi i nënshkrimeve të stafit të Qendrës Burimore, gjykata ka vërtetuar se sindikalistët e shkollës ku paditësja punon kanë dhënë nënshkrimet e tyre kundër konkursit të datë 21.12.2021.

Nga leximi i kontratës së punës me numër të protokollit 3/1048-35 datë 02.03.2016, gjykata ka vërtetuar se paditësja M.M., ka lidhur kontratë pune me MASHT në Prishtinë për vendin e punës Edukatore në Shkollë, pranë institucionin arsimor Q.B “Nëna Terezë” në Prizren, me 40 orë pune në javë. E njejta ka kualifikim shkollor- fakultet të edukimit, Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Në nenin 5 të kësaj kontrate është paraparë që në rast të ndërrimit të fondit të orëve të punës apo mësimin në procesin arsimor do të lidhet kontratë e re.

Nga leximi i aktvendimit mbi licencimin e mësimdhënësit me numër 08/2013/11511, gjykata ka vërtetuar se paditeses M.M., i është lëshuar licenca e mësimdhënëses së karrierës.

Nga leximi i vërtetimit të datës 12.04.2022, gjykata ka vërtetuar se sipas vërtetimit të lëshuar nga drejtori i Qendrës burimore “Nëna Terezë” , rezulton se paditësja M.M., i mban 19 orë në javë gjuhë shqipe deri sa të zgjidhet kandidati sipas konkursit të rregullt.

Nga leximi i vërtetimit 14.12.2022, gjykata ka vërtetuar se sipas vërtetimit të lëshuar nga drejtori i Qendrës burimore “Nëna Terezë” , paditësja M.M., me kontratë të punës është edukatore pranë këtij institucioni arsimor por se në mungesë të mësimdhënësve të lëndëve të caktuara është angazhuar edhe si mësimdhënëse e gjuhës shqipe.

Nga leximi i listës së ndarjeve të orëve mësimore 09.06.2021, gjykata ka vërtetuar se paditësja për vitin 2020/2021 ka gjithsej 15 orë gjuhë shqipe, 1 orë art muzikor, 1 teknologji e veshjes dhe 1 përgatitja e veshjeve.

Nga leximi i listës së individualizuar për orët e gjuhës shqipe, gjykata ka vërtetuar se paditësja M.M., ka mbajtur lëndën e gjuhës shqipe.

Nga leximi i orarit mësimor 2018-2019 dhe 2019-2020, gjykata ka vërtetuar se paditësja M.M., është planifikuar të mbaj orët e gjuhës shqipe.

Nga leximi i faqeve të ditarit të vitit 2018, gjykata ka vërtetuar se paditësja ka mbajtur orët e gjuhës shqipe.

Nga leximi i planprogramit të orëve 2022, gjykata ka vërtetuar se të njëjtin e ka hartuar këtu paditësja M.M.,.

Nga leximi i ankesës së datës 01.06.2022, gjykata ka vërtetuar se paditësja ka parashtruar ankesë, për faktin se e njëjta ka qenë e pakënaqur me mospërzgjedhjen e saj dhe procedurën e ndjekur nga ana e këtu të paditurës me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit për vendin e punës mësimdhënës i gjuhës shqipe.

Nga leximi i përgjigjes në ankesë 02.03.2022, gjykata ka vërtetuar se Inspektorati i Arsimit në Prizren e ka njoftuar paditësen se i njëjti nuk ka kompetencë për shqyrtimin e asnesës së saj të parashtruar me datë 04.02.2022.

Nga leximi i shpalljes së konkursit të datës 21.12.2021, gjykata ka vërtetuar se është hapur konkurs, gjegjësisht rishpallje e konkursit për pozitën mësimdhënëse e gjuhës shqipe në qendrën burimore “Nëna Tereza” në Prizren.

Nga leximi i vendimit mbi emërimin e komisionit të datës 12.01.2022, gjykata ka vërtetuar se përmes këtij vendimi është emëruar komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për mësimdhënës të gjuhës shqipe në qendrën burimore Nëna Tereza në Prizren në përbërje të: Y.Sh., Besmira Thaqi, Elhame Llapashtica dhe Vedat Serbica.

Nga leximi i njoftimit mbi përzgjedhjen e kandidatëve, gjykata ka vërtetuar paditësja M.M., nuk ka qenë në mesin e kandidatëve të përzgjedhur për pozitën mësimdhënëse e gjuhës shqipe në AMU.

Nga leximi i testit me shkrim gjykata ka vërtetuar se paditësja M.M., i është nënshtruar testimit me shkrim për pozitën e mësimdhënëses së gjuhës shqipe, dhe e njëjta nga komisioni vlerësues është vlerësuar me 34.5 pikë nga 100 pikë të mundshme.

Nga leximi i njoftimit për kandidatin e përzgjedhur për pozitën mësimdhënës i gjuhës shqipe, gjykata ka vërtetuar se për këtë pozitë është përzgjedhur Aid Qaflehi me 55 pikë.

Neni 64 par.1 i Ligjit për Zyrtarët Publik parasheh: “*Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të Ligjit, marrëdhënia e punësimit për nëpunësin e Shërbimit Publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës*”. Neni 66 par.1 parasheh: “*Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe me ligj të veçantë, marrëdhënia e punës e punëtorit të shërbimeve publike themelohet me kontratën e punës për një periudhë të pacaktuar*”. Neni 67 par.1 i po këtij ligji parasheh : “*Themelimi i marrëdhënies së punës për një nëpunës të Shërbimit Publik bëhet vetëm në bazë të një konkursi publik dhe të hapur, të organizuar sipas këtij ligji.*”

Ndërsa Udhëzimi Administrativ (MPMS), nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, konkretisht në nenin 4 paragrafi 1 të këtij Udhëzimi parashihet: “*Konkursin Publik për plotësimin e vendeve të lira të punës, e shpall organi kompetent i autorizuar me Statutin apo Aktin Brendshëm*”. Ndërsa paragrafi 6 të këtij neni parashihet: “*Përfundimisht nga paragrafi 1 të këtij neni, organi përkatës i autorizuar me Statutin apo Aktin e*

Brendshëm duhet fillimisht të shpallë konkurs të brendshëm, nëse ka më shumë se një kandidat, të cilët i plotësojnë kushtet e kërkuara për plotësimin vendit të lirë të punës”

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësja M.M., është e punësuar pranë të paditurës, gjegjësisht e njejta është e punësuar pranë institucionit arsimor Qendrës Burimore “Nëna Terezë” në Prizren. Marrëdhënia e punës e paditëses pranë të paditurës është themeluar në bazë të kontratës së punës me numër të protokollit 3/1043/35, në bazë të së cilës palët kontraktuese janë dakorduar që paditësja të kryej punën e edukatores, ku kanë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet mes tyre.

Kontestuese mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte edhe fakti se me rastin e hapjes së konkursit për mësimdhënës të gjuhës shqipe pranë kësaj shkolle kishte konkuruar edhe paditësja M.M., por se e njejta nuk ishte përzgjedhur.

Kontestuese mes palëve ishte çështja-kërkesa e ndërrimit e kontratës së punës nga edukatore në mësimdhënës e gjuhës shqipe si dhe kompensimi i të ardhurave personale dhe nëse ka bazë ligjore që e lejon një gjë të tillë të bëhet në procedurë gjyqësore.

Nisur nga dispozitat ligjore të lartëcituara, gjykata erdhi në pëfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar dhe nuk gjen mbështetje ligjore për aprovimin e së njëjtës. Në bazë të dispozitave të lartëcituara rrjedh se një pozitë, gjegjësisht një vend pune për nënpunësit e shërbimit publik (mësimdhënës) mund të themelohet vetëm në bazë të kontratës së punës, e cila lidhet pas përzgjedhjes së kandidatit të suksesshëm pas përmbylljes të një konkursi publik, qoftë konkursi të brendshëm (kur plotësohen kushtet për një të tillë), qoftë në bazë të një konkursi publik të jashtëm.

Nga provat e cekura me lartë, rrjedh se paditësja M.M., ka konkuruar në konkursin e hapur nga e paditura për vendin e punës –mësimdhënës e gjuhës shqipe. Në rastin konkret paditësja në këtë procedurë nuk e ka atakuar konkursin por kërkesëpadia e saj ka qenë ndërrimi i kontratës së punës nga kontrata e punës e edukatores të cilën aktualisht e ka, të i ndërrohet me kontratë të punës si mësimdhënës e gjuhës shqipe. Por gjykata vlerëson se kontrata është vullnet i dy palëve kontraktuese, në të cilën pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të lirë, që në pajtim me dispozitat urdhëruese, të rendit publik dhe të dokeve të mira, t’i rregullojnë marrëdhëniet e veta. Prandaj në rastin konkret gjykata nuk mund të lidh apo të ndërroj kontratë pune për paditësen, dhe një kërkesë e tillë sipas bindjes së kësaj gjykate është e papranueshme dhe nuk gjen bazë ligjore.

Dispozita e nenit 38 të Ligjit për Zyrtarët Publik së cilës i referohet e paditura si bazë për aprovimin e kërkesës së saj (ndërrimin e kontratës së punë) nuk vlen në rastin konkret, sepse ajo dispozitë vlen për shërbyesit civil ndërsa paditësja mban pozitën e shërbyeses publike (nënpunësit e institucioneve arsimore janë shërbyes publik). Por edhe përkundër kësaj gjykata vlerëson se në të gjitha rastet ligjvënësi ka paraparë procedurat ligjore për themelimin e marrëdhënies së punës, e të cilat në rastin konkret janë shpallja e konkursit, përzgjedhja e kandidatit dhe në fund lidhja e kontratës së punës në mes palëve kontraktuese, ndërsa roli i gjykatës në kontestet e punës është që të vlerësoj ligjshmërinë e vendimeve gjatë kësaj procedure, nëse pala mendon se punëdhënësi i ka shkelur në ndonjë mënyrë të drejtat e tij, por se gjykata nuk ka tagër dhe as kompetencë që të lidh kontrata të punës për palët ndërgjyqëse. Edhe fakti se paditësja ka mbajtur orët e gjuhës shqipe në mungesë të stafit dhe për plotësim të normës së saj të orëve, nuk është bazë për aprovimin e kësaj kërkesë.

Në anën tjetër sa i përket kërkesës për kompensimin e të ardhurave personale, gjykata e refuzoi si të pabazuar për faktin se palët ndërgjyqëse kanë një kontratë të lidhur mes vete, e ndër të tjera janë marrë vesh edhe për lartësinë e pagës, kontratë kjo e cila supozohet të jetë lidhur me vullnetin dhe pajtimin e të dyja palëve kontraktuese, gjegjësisht supozohet se paditësja është pajtuar për këtë lartësi të pagës. Edhe tek kompensimi i të ardhurva personale plotësimi i normës së edukatores me orë të gjuhës shqipe nuk është bazë për aprovimin e kërkesës për këtë kompensim.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës vendosi konform nenit 463 të LPK-së, pasi që pala e paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale në mënyrë të specifikuar, përkundër faktit se ky aktgjykim është në favor të saj.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e duke u bazuar në dispozitat ligjore të këtij aktgjykimi të cekura si në arsyetimin e tij e lidhur me nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:223938, 13.07.2023

G j y q t a r e
Njomëza Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.